

## PËRMBAJTJA:

### PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- I. Aktivitetet e programuara dhe ato të kryera për cdo program mbështetje
- II. Rezultatet përfundimtare të arritura për cdo program
- III. Problemet e ndeshura, efektet e tyre dhe si janë trajtuar dhe kapërcyer ato për cdo mase
- IV. Aspekte pozitive të zbatimit të skemës së mbështetjes 2008

### ANEKSE

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Gjatë vitit 2008, në kuadër të “Strategjisë Sektoriale të Bujqësisë dhe Ushqimit 2007 – 2013” të Qeverisë Shqiptare, bazuar në Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, dhe në bazë të VKM Nr.10, datë 04.01.2008, “Për mbështetjen e Prodhimit Bujqësor”, Udhëzimit të përbashkët të M.B.U.M.K. dhe Ministrisë së Financave Nr. 1/1, datë 13.02.2008, në zbatim të tij, si dhe urdhërave të Ministrit të BUMK z. Jemin Gjana, të Zv. Ministrit të BUMK z. Ndoc Faslia, të Drejtorit të Projektit 2KR, etj, u zbatua programi i skemave të mbështetjes për bujqësinë nga buxheti i shtetit.

Zbatimi i kësaj skeme të mbështetjes financiare të fermerëve nga buxheti i shtetit pati si objektiv nxitjen e rritjes së prodhimit në sektorët e pentarisë, vreshtarisë dhe ullishteve të cilët janë dhe sektorë prioritarë në kuadër të zhvillimit të bujqësisë. Rritja e prodhimit në këta sektorë do të bëjë të mundur rritjen e mundësive për konkurim të prodhimeve bujqësore shqiptare në tregjet rajonale dhe evropiane, gjë që do të sjellë dhe rritjen e të ardhurave të fermerëve vendas dhe rritjen e mirëqënies të familjeve fermere shqiptare.

### **I. Aktivitetet e programuara dhe të kryera në fakt për cdo program**

Për zbatimin sa më efikas të programit të skemave të mbështetjes për bujqësinë nga ana e MBUMK, Projektit 2KR dhe DRBUMK-ve të të 12 qarqeve janë kryer një sërë aktivitetesh promovuese, administrative, etj..

#### **1.1 Informimi**

Për promovimin e zbatimit të skemës së mbështetjes për bujqësinë është hartuar “Plani i Komunikimit” nga Drejtori i Projektit 2KR. Është bërë një takim prezantues dhe informues me pjesëmarrjen e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit z. Jemin Gjana dhe Ministrin e Financave z. Ridvan Bode. Në këtë takim u informuan specialistët MBUMK, Drejtoritë Rajonale të BUMK, KASH-i, anëtarët e shoqatave të bujqësisë, grupet e interesit, fermerë, media elektronike dhe e shkruar etj. Në këtë takim u sqaruan shumë aspekte të skemës së mbështetjes

financiare 2008 për bujqësinë nga Ministri i BUMK dhe Ministri i Financave. Në këtë takim u shpërndanë dhe fletëpalosje informuese për skemën e mbështetjes 2008.

Gjithashtu DRBUMK-të kanë bërë njoftimet e tyre për zbatimin e kësaj skeme në të gjithë qarqet e vendit.

Është bërë informimi për zbatimin e skemës nëpërmjet intervistave televizive nga drejtorët e DRBUMK-ve dhe Drejtori i Projektit 2KR, artikujve dhe intervistave në shtyp nga Drejtori i Projektit 2KR, specialistët e projektit etj.

## 1.2 Pranimi i dokumentacionit

Pasi kanë marrë informacionin, fermerët kanë aplikuar në zyrat e bujqësisë të rretheve duke plotësuar kërkesën dhe dokumentacionin e projektit sipas formularëve përkatës të përcaktuar në udhëzim për fushat ku aplikuesit kanë qënë të interesuar për të përfituar mbështetje financiare si në mbjelljet e reja në pemtari, vreshtari dhe ullishte, fermat blegtorale me lopë dhe blegtorët me tufa dhensh, subvencionimi i prodhimit të vajit të ullirit ekstra vergine, skema e subvencionimit të ndërrimit të sistemit djegës të serave me ngrohje, prodhimet “Bio”, interesat e kredive etj.

## 1.3 Skema e mbështetjes së mbjelljeve të reja në Pemtari, Vreshtari dhe Ullishte

### 1.3.1 Vlerësimi i projekteve

Në kuadër të skemës së mbjelljeve të reja në pemtari vreshtari dhe ullishte kanë aplikuar në të gjithë vendin 3.204 fermerë.

Në të gjitha DRBUMK-të është kryer procesi i vlerësimit me sistem pikësh për projektet e paraqitura sipas Udhëzimit të mësipërm.

Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit të projekteve sipas afateve të përcaktuara në udhëzim u krye vlerësimi dhe renditja e projekteve në projekte fitues dhe projekte jofitues. Në të gjithë vendin nga DRBUMK-të janë shpallur fitues **2.990** projekte të cilat janë vlerësuar me mbi 70 pikë.

### 1.3.2 Verifikimi

Mbas fazës së vlerësimit dhe renditjes së projekteve sipas pikëve të fituara, është kryer verifikimi i projekteve në terren nga grupet e verifikimit të ngritur në cdo DRBUMK. Në përbërje të këtyre grupeve ka patur specialistë të DRBUMK dhe

përfaqësues të Projektit 2KR për rrethin përkatës. Janë verifikuar rreth 2,990 projekte dhe janë skualifikuar nga grupet e verifikimit rreth 275 projekte.

Projektet të cilat gjatë verifikimit rezultuan të zbatuara konform projektit të paraqitur, u dërguan në Projektin 2KR në Tiranë për financim.

Dokumentacioni i projekteve të sjella për financim është kontrolluar nga specialistët e Projektit 2KR për rregullsinë e dokumentacionit përpara se të dërgohej për likuidim financiar. Projektet të cilat kanë dalë me probleme në dokumentacion janë rikthyer në DRBUMK-të përkatëse për rregullim ose janë skualifikuar.

### 1.3.3 Auditimi

Nga ana e specialistëve të Projektit 2KR është kryer auditimi në terren i 25% të projekteve të ardhura nga cdo DRBUMK për financim sipas udhëzimit dhe në përputhje me urdhërin e Drejtorit të Projektit 2KR. Ky auditim është kryer në bazë të një Programi Vjetor Kontrolli paraprak të hartuar nga drejtoria e Projektit 2KR, si dhe Programeve të Kontrollit të nxjerra për cdo auditim nga Drejtori i Projektit 2KR. Në bazë të listave të fituesve të ardhura në Projektin 2KR është kryer përgjedhja e projekteve që do të auditohen në terren. Kjo përzgjedhje është kryer duke u bazuar në madhësinë e sipërfaqes së projektit për mbjellje, kultura e mbjellë etj. Para auditimit në terren për zbatimin e projektit është kontrolluar dokumentacioni i projekteve të përzgjedhura. Për një transparencë në procesin e auditimit, ky proces është kryer gjithmonë në praninë e anëtarëve të grupit të verifikimit të DRBUMK-ve përkatëse dhe të përfaqësuesit të Projektit 2KR në qark. Gjatë procesit të auditimit për zbatimin e projekteve në terren janë kontrolluar elementë të ndryshëm të projekteve si matja e sipërfaqes së parcelave, matja e distancave të mbjelljes së fidanëve dhe përputhshëria e të dhënave të marra me ato të paraqitura në project, kontroll i funksionionimit të sistemeve të ujitjes me pika, burimi i marrjes së ujit, kontrolli i matrikujve të dhenve dhe të gjedhit dhe krahasimi i tyre me ato të paraqitura në projekte etj. Mbasi kryerjes së këtij procesi në terren, është informuar Drejtori i Projektit 2KR dhe DRBUMK-ja përkatëse për konkluzionet e arritura nga auditimi dhe masat e marra. Kjo praktikë punë ka rritur nivelin e transparencies, të bashkëpunimit midis Projektit 2KR dhe të DRBUMK-ve, të rritjes së nivelit teknik nga dhënia e mendimeve dhe zgjidhjeve të problemeve të dala gjatë procesit të auditimit, këto faktorë kanë ndikuar në arritjen e rezultateve positive të punës së Projektit 2KR gjatë zbatimit të skemës së mbështetjes për bujqësinë 2008. Deri në datën 31.12.2008 janë audituar rreth 635 projekte. Nga

këto projekte të audituara janë skualifikuar 11 projekte në Berat, Dibër, Korçë, Vlorë për sipërfaqe më të vogël se ajo e pasqyruar në projekt, mosplotësimi i limitit të sipërfaqes, mbjellje të viteve ta kaluara, projekte me dy kultura, projekte me dy ose më shumë ngastra etj.

#### 1.3.4 Financimi

Mbas kontrollit për rregullsinë e dokumentacionit nga specialistët e Projektit 2KR të projekteve të ardhura bëhet financimi i tyre nëpërmjet sektorit të financës së Projektit 2KR direkt në llogaritë bankare të fermerëve. Nga Projekti 2KR sipas kapaciteteve dhe infrastrukturës së tij, përgjithësisht është ndjekur procedura e auditimit të 25% të projekteve për cdo DRBUMK, para likujdimit financiar. Kjo ka bërë të mundur eliminimin e debitorëve.

### 1.4 Ndërrimi i sistemit të djegies të Serave me Ngrohje

Skema e subvencionimit të subjekteve të serave me ngrohje për ndërrimin e sistemit të djegies nga naftë në solar

Kanë aplikuar gjithsej 94 subjekte serash me ngrohje me nje sipërfaqe 50.4 ha.

Janë verifikuar në vend 94 projekte ose 100% e numrit të përgjithshëm të aplikimeve. Subjektet të cilat kishin deklaruar se nuk ishin gati për verifikim gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2008 kanë njoftuar DRBUMK përkatëse gjatë periudhës së dytë të aplikimeve, periudhë kur kanë kryer ndërrimin e sistemit të djegies sipas udhëzimit dhe janë verifikuar gjatë periudhës nëntor – dhjetor dhe mbas kryerjes së të gjitha procedurave janë likujduar financiarisht. Janë financuar gjatë vitit 2008, 71 subjekte të prodhimit të perimeve në serat me ngrohje.

Për qarkun e Beratit fermerët i kanë rritur sipërfaqet e serave me ngrohje, gjë e cila është pasqyruar dhe në Vjetarin Statistikor 2007. Bazuar në këto të dhëna u krye shtim fondesh për këtë qark sipas Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Nr. 286, datë 30.06.2008.

Për këtë skemë mbështetje nuk ka patur procedura vlerësimi, që do të thotë se kanë përfituar të gjithë fermerët që gjatë verifikimit kanë rezultuar se e kanë ndërruar sistemin e djegies të kaldajave në sera.

## 1.5 Subvencionimi i prodhimit të Vajit të Ullirit Ekstra Verxhine

Për promovimin e kësaj skeme janë zhvilluar disa takime informuese të specialistëve të Projektit 2KR dhe të DRBUMK-ve me prodhuesit potencialë të vajit të ullirit të qarqeve Berat, Fier, Tiranë dhe Vlorë.

Deri në datën 31.12.2008, janë dorëzuar në Projektin 2KR ku janë kryer procedurat e kontrollit të dokumentacionit dhe janë financuar 2 subjekte për prodhimin e vajit ekstra verxhine nga DRBUMK- Vlorë dhe Elbasan duke plotësuar standardet për subvencionimin. Subjekti i prodhimit të vajit të ullirit ekstra vergine të rrethit Vlorë ka aplikuar 2 herë për prodhimin e vajit ekstra vergine në periudhën janar – shkurt dhe tetor – nëntor 2008.

## 1.6 Luftimi i Mizës së Ullirit

Skema e luftimit të mizës së ullirit në Berat, Durrës, Vlorë.

Në datën 04.05.2008 është zhvilluar tenderi për përzgjedhjen e firmës për kryerjen e procesit të luftimit të mizës së ullirit. Ky tender u anulua pasi asnjëri nga operatorët e paraqitur nuk i përmbushte kriteret e vendosura nga Projekti 2KR në bashkëpunim me DSHMB.

Në datën 30.06.2008 u zhvillua përsëri tenderi për përzgjedhjen e firmës për kryerjen e procesit të luftimit të mizës së ullirit. Ky tender përzgjodhi subjektet të cilat do të kryenin procesin e trajtimit të ullishteve kundërt dëmtuesve.

Në periudhën korrik – gusht 2008 u krye procesi i trajtimit ekologjik të ullishteve të rretheve Berat 370 Ha, Durrës 130 Ha dhe Vlorë 500 Ha me EkoTrape për luftimin e mizës së ullirit. Sipërfaqja e përgjithshme trajtuar me këtë metodë ishte 1,000 Ha.

## 1.7 Skema e subvencionimit të Blegtorisë

Në kuadër të kësaj skeme është zbatuar subvencioni për fermat blegtorale të lopëve me drejtim prodhim qumështi dhe të blegtorëve me tufa dhensh të cilët kanë shtegtuar në rrethet e tjera. Nga kjo skemë nuk kanë përfituar mbështetje financiare lopët e rracës së vendit dhe tufat e dhensh të cilat nuk kanë shtegtuar.

Për fermat blegtorale të lopëve të qumështit janë kryer aplikimet në DRBUMK-të dhe verifikimet nga grupet e verifikimit të DRBUMK-ve dhe të Projektit 2KR për ato tufa

ku ishte kryer procesi i matrikullimit të lopëve dhe të pajisura me dokumentacionin e duhur nga organet e veterinary dhe higjieno – sanitare. Në kuadër të kësaj skeme janë financuar nga Projekti 2KR 843 ferma lopësh me drejtim prodhim qumështi.

Për blegtorët të cilët kanë patur tufa dhensh të cilat kanë shtegtuar jashtë rrethit janë kryer aplikimet në DRBUMK-të dhe verifikimet në përputhje me fazat e ndryshme të zbatimit të skemës së mbështetjes si verifikimi para shtegimit dhe verifikimi mbas shtegimit. Verifikimet u kryen për ato tufa të cilat kishin mbaruar procesin e matrikullimit të dhenve dhe ishin pajisur me dokumentet nga organet veterinare. Në kuadër të kësaj skeme subvencionimi janë financuar 384 tufa dhensh.

Për këtë skemë mbështetje nuk ka patur procedura vlerësimi, që do të thotë se kanë përfituar të gjithë fermerët që gjatë verifikimit kanë rezultuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në udhëzimin e përmenduar më sipër.

### 1.8 Skema e subvencionimit të projekteve të Ujitjes me Pika

Projekti 2KR ka kryer të gjitha procedurat për zbatimin e kësaj skeme, si kontrolli administrativ i dokumentacionit të projekteve përfituese të ardhura nga DRBUMK-të në Projektin 2KR në Tiranë dhe verifikimi në terren i 25% të numrit të tyre.

Pasi mbarimit të këtyre procedurave, nga ana e Projektit 2KR është kryer likujdimi financiar i aplikuesve drejtpërdrejt në llogaritë e tyre bankaren. Projekti 2KR ka kryer financimin e 178 projekteve të ujitjes me pika në të gjithë qarqet e vendit me një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 149 Ha.

### 1.9 Skema e subvencionimit të fidanishteve me Kultivarë Autoktonë

Në qarkun Shkodër kanë aplikuar 3 fermerë për prodhim fidanësh të kultivarit “Kallmet”. Në qarkun Lezhë ka aplikuar 1 fermer për prodhim fidanësh të kultivarit “Kallmet”. Nga Projekti 2KR është bërë pritja e dokumentacionit të sjellë nga DRBUMK Lezhë dhe Shkodër, është kryer kontrolli administrative i dokumentacionit të aplikantëve dhe kontrolli në terren për zbatimin e projektit sipas parashikimit. Mbas kontrollit në terren është kryer likujdimi financiar i aplikantëve.

## 1.10 Skema e subvencionimit të Fermave “Bio”

Kanë aplikuar në fillim të vitit 24 fermerë me drejtim prodhim perimesh “Bio”, të qarqeve Durrës, Tiranë, Vlorë. Në Projektin 2KR u krye kontrolli I dokumentacionit për të gjithë aplikantët. Gjatë fazës së parë u s’kualifikuan 9 fermerë të qarqeve Tiranë dhe Durrës për mosplotësim të dokumentacionit.

Në fazën e dytë u s’kualifikuan dhe 7 fermerë të tjerë sepse nuk plotësuan dokumentacionin e nevojshëm. U financuan 8 fermerë në qarkun e Durrësit dhe Vlorës.

## 1.11 Skema e subvencionimit të Normës së Interesit të Kredive Bujqësore

Në kuadër të kësaj skeme kanë aplikuar 34 subjekte private në 10 qarqe të vendit. Dokumentacioni i këtyre subjekteve është dorëzuar në Projektin 2KR ku dhe është marrë në shqyrtim nga komisioni i vlerësimit i ngritur për këtë qëllim sipas Udhëzimit. Janë shpallur fitues 34 subjekte. Shuma e financimit të kërkuar për subvencionin e interesit është 46,530,063 lekë dhe kanë përfituar subvencion të normës së interesit 11 subjekte.

## **II. Rezultatet përfundimtare të arritura për cdo program**

Deri në datën 31.12.2008, janë financuar në të gjitha skemat e mbështetjes për bujqësinë **7,599 fermerë** në një shumë prej 854,623,148 lekë ose 99.37% e fondit të planifikuar (Aneksi 1).

### **2.1 Skema e mbështetjes së mbjelljeve të reja në Pentari, Vreshtari dhe Ullishte**

Për këtë skemë deri në datën 31.12.2008 janë financuar 2,580 projekte gjithsej me një sipërfaqe prej 1,772.323 Ha dhe realizim fondi prej 580,738,680 lekë ose 99.88 % e fondit të planifikuar. Projektet e financuara sipas specieve ose grupspecieave janë si më poshtë (Aneksi 2):

- ❖ **Pemë frutore, janë mbjellë 805.857 Ha ose 45 % e sipërfaqes.**
- ❖ **Ullishte, janë mbjellë 705.86 Ha ose 40 % e sipërfaqes.**
- ❖ **Vreshta, janë mbjellë 246.728 Ha ose 14 % e sipërfaqes.**
- ❖ **Agrume, janë mbjellë 13.874 Ha ose 1% e sipërfaqes.**

Në pentari, kultura dominuese në mbjellje është kultura e kumbullës me 288.192 Ha ose 36 % të sipërfaqes së mbjellë me pentore (Aneksi 3).

Janë financuar 409 projekte me sipërfaqe 1 ose më shumë se 1 Ha. Numri i tyre zë 16% të numrit të projekteve të financuara ose 33 % të vlerës së likuiduar financiarisht për mbjelljet e reja (Aneksi 4).

### **2.2 Ndërrimi i sistemit të djegies në serat me ngrohje**

Në kuadër të kësaj skeme janë financuar 71 aplikime ose 75.5 % e numrit të subjekteve që kanë aplikuar.

Sipërfaqja e subjekteve të serave që janë financuar është 37.78 ha ose 75 % e sipërfaqes gjithsej të aplikuar.

Fondi i financuar është 56,684,398 lekë ose 99.07 % e fondit të planifikuar prej 57,219,000 lekë (Aneksi 5).

### 2.3 Subvencionimi i prodhimit të vajit të ullirit Ekstra Verxhine

Janë financuar në kuadër të kësaj skeme në rrethet Elbasan dhe Vlorë 2 subjekte për prodhimin e 27,300 litra vaj ekstra vergine me një shumë prej 2,730,000 lekë ose 82.95% e fondit të planifikuar (Aneksi 6).

### 2.4 Luftimi i Mizës së Ullirit

Në kuadër të kësaj skeme, deri në datën 31.12.2008 janë trajtuar me metodën e Eko Trapeve ullishtet në zonat e Beratit, Durrësit dhe Vlorës me një sipërfaqe prej 1,000 Ha dhe 3,521 fermerë përfitues të trajtimit, ku në Berat kanë përfituar 1,723 fermerë, në Durrës 667 fermerë dhe në Vlorë 1,131 fermerë.

Është realizuar plani në masën 99.99% ose në 18,375,000 lekë të realizuara nga 18,376,000 lekë të planifikuara.

### 2.5 Skema e subvencionimit të Blegtorisë

Skema e subvencionimit të fermave të lopëve me drejtim prodhim qumështi.

Në kuadër të kësaj skeme deri në datën 31.12.2008 janë paraqitur në Projektin 2KR dhe janë financuar 843 ferma me tufa lopësh me një shumë prej 120,079,800 lekë ose 98.39% të fondit të planifikuar prej 122,050,000 lekë (Aneksi 8/1).

Skema e subvencionimit të shtegtimit të tufave të dhenve.

Në kuadër të kësaj skeme, deri në datën 31.12.2008 janë financuar 384 blegtorë me tufa dhensh në rrethet Gjirokastër, Korçë dhe Vlorë me një shumë prej 26,200,000 lekë ose 98.68% të fondit të planifikuar (Aneksi 8/2).

### 2.6 Skema e subvencionimit të ujitjes me pika

Për këtë skemë kanë aplikuar në DRBUMK-të gjithsej 266 projekte. Janë dorëzuar në Projektin 2KR 178 projekte me një sipërfaqe të përgjithshme prej 148.658 Ha pemtore. Është zbatuar nga Projekti 2KR në përputhje me udhëzimin auditimi i 25% projekteve të ujitjes me pika në të gjithë territorin e vendit.

Shuma e financimit është 44,597,410 lekë ose 99.73% të fondit të planifikuar prej 44,717,000 lekë (Aneksi 9).

## 2.7 Skema e subvencionimit të fermave “Bio”

Për këtë skemë kanë aplikuar 15 fermerë dhe janë financuar 8 fermerë me një fond prej 73,600 lekë ose 30.67% të fondit të planifikuar prej 240,000 lekë (Aneksi 9). Ky proces është realizuar gjatë muajve shtator – dhjetor 2008.

## 2.8 Skema e subvencionimit të fidanishteve me kultivarë autoktonë

Janë realizuar dhe financuar 4 projekte të fidanishteve të kultivarit të rrushtit “Kallmet”, 3 projekte në rrethin Shkodër dhe 1 projekt në rrethin Lezhe me një realizim prej 1,761,600 lekë ose 99.98% të fondit të planifikuar prej 1,762,000 lekë.

## 2.8 Skema e subvencionimit të normës së interesit për kreditë bujqësore

Për zbatimin sa më efikas të kësaj skeme, Projekti 2KR ka lidhur akt marrëveshje me Bankën e Shqipërisë, Raiffeisen Bank, BKT, Bankën Popullore, Tirana Bank, NBG, Pro Credit Bank, Emporiki Bank, Alpha Bank, Union Bank dhe me Fondin e Zhvillimit të Zonave Malore, Fondin Besa, Opportunity Albania, PSHM etj. Deri në datën 31.12.2008 kanë sjellë dokumenta nga bankat për përfitim kredie në Projektin 2KR, 11 subjekte private gjithsej dhe janë financuar të gjitha me një realizim prej 3,382,660 lekë ose 77.67% të fondit të planifikuar prej 4,355,000 lekë. (Aneksi 12).

### **III. Problemet e ndeshura, efektet e tyre dhe si janë trajtuar dhe kapërcyer ato**

Gjatë zbatimit të skemave të mbështetjes për bujqësinë 2008 janë hasur dhe disa probleme dhe vështirësi të pasqyruara si më poshtë:

Gjatë zbatimit të skemës së mbështetjes financiare për mbjelljet e reja në pemtari, vreshtari dhe ullishte, janë hasur probleme në zbatimin në terren të projekteve gjë që solli dhe skualifikimin e këtyre projekteve nga lista e projekteve fitues si projekte të zbatuar në 2 ose më shumë parcela, fidanë të mbjellë vitet e kaluara, sipërfaqe më e vogël se ajo e pasqyruar në projekt, mbjellja e një ose më shumë kulturave etj.

Në DRBUMK-të ku numri i aplikuesve ishte më i lartë se numri i projekteve përfituese kriteret e vlerësimit të projekteve nuk janë përcaktuar shumë qartë si në DRBUMK Fier, Dibër, Korçë, Vlorë etj.. Në këto DRBUMK kanë marrë pikë maksimale projekte me një sipërfaqe më të vogël ose kanë marrë numër të njëjtë vlerësim pikësh projekte me sipërfaqe të ndryshme.

Ky problem duhet të zgjidhet në të ardhmen me përpilimin e matricave të vlerësimit sasior të projekteve.

Problemet e dala gjatë kontrollit të dokumentacionit në Projektin 2KR dhe nga auditimi në terren i projekteve janë: Përgjithësisht nga DRBUMK-të (komisionet e vlerësimit dhe ato të verifikimit) nuk bëhet kujdes për plotësimin e dokumentacionit në përputhje me kriteret e përcaktuara në udhëzimin. Kjo vërtetohet nga numri i madh i dokumentave të projekteve të kthyer për plotësim. Edhe në këto raste ekziston një mungesë vullneti e theksuar nga ana e tyre për plotësimin e dokumentacionit duke u justifikuar me terrenin apo duke nxjerrë në plan të parë fermerët. Ky fenomen është përgjegjësi e specialistëve të bujqësisë duke filluar që nga hartimi i dokumentit të projektit, komisionet e vlerësimit që bëjnë vlerësimet e tyre dhe deri tek komisionet e verifikimit që përcjellin dokumenta projektësh jashtë kriterëve për financim. Në këto kushte shpeshherë Projekti 2KR është vënë përballë vështirësive dhe problemeve që ka sjellë kjo parregullsi. Është e vërtetë që fermerët nuk kanë përgjegjësi për dokumentacionin dhe kërkojnë financimin e punës së kryer, por këtë përgjegjësi e kanë drejtorët e DRBUMK-ve me strukturat e tyre. Nuk është shënuar numri faktik i bimëve të mbjella (DRBUMK Fier, Korçë, Vlorë), mbjelljet janë kryer në më shumë

se një parcelë (Korce, Shkodër) etj. Akt Verifikimi (Formulari 22) i zbatimit të projektit në terren nuk është plotësuar konform udhëzimit si për numrin serial të fidanëve të blerë ashtu dhe për numrin faktik të fidanëve të mbjellë (Lezhë, Korce, Tiranë, Vlorë). Nuk janë zbatuar të gjitha teknologjitë e kultivimit të kulturave bujqësore, nuk është pluguar ngastra para mbjelljes, piketimi jo i saktë i ngastrave etj. Dokumentacioni i pronësisë së tokës është pasqyruar me anë vërtetimesh të lëshuara nga kryetarët e komunave pa përcaktuar numrin kadastral të parcelës ose kufizuesit e saj (Dibër, Kukës, Shkodër). Skicat e projekteve nuk japin elementë teknikë të projektit. Janë depozituar në Projektin 2KR për likuidim dokumente projektsh që nuk janë në listën e e vlerësimit të dërguar nga DRBUMK pranë Projektit 2KR në përfundim të vlerësimit. Janë dorëzuar për likuidim projekte me sipërfaqe më të madhe se sa në listën e vlerësimit (Dibër). Dokumentat e projekteve të skualifikuara në DRBUMK-të nuk janë të paisur me aktin e verifikimit ku janë vlerësuar si projekte të skualifikuara. Ka patur vonesa në dorëzimin e dokumentave të projekteve nga DRBUMK-të në Projektin 2KR si DRBUMK Fier, Vlore, Elbasan, Korce etj. Ka patur raste të dorëzimit të dokumentave të projekteve pa firmën e përfaqësuesit të Projektit 2KR në formularin 22 të aktit të verifikimit në terren si në rrethet Lezhe, Lushnje etj. Aftësi të ulët të menaxhimit të projekteve gjë që ka vonuar procesin e dërgimit të dokumentacionit të projekteve për financim në Projektin 2KR në Tiranë si në qarqet Dibër, Fier, Vlorë etj.

Në lidhje me financimin e projekteve, probleme janë hasur në emrat e aplikuesve ku shumë herë ato nuk korrespondojnë me emrin në numrat e llogarive, sepse emri në aplikim nuk është shënuar sic e ka personi në pasaportë ose janë hapur llogari bankare në emër të personave të tjerë.

Dokumentat e projekteve me probleme u janë kthyer përsëri DRBUMK-ve përkatëse për rregullimet dhe plotësimet e duhura gjë që ka shkaktuar vonesa në likuidimin financiar të projekteve dhe zbatimin e skemës në tërësi.

Për skemën e blegtorisë në disa qarqe nuk ka përfunduar matrikullimi i gjedhëve prandaj pritet që të kryhet ky proces në fillim për të hapur rrugën e zbatimit të skemës së mbështetjes financiare.

Janë hasur vështirësi logjistike për verifikimet e tufave të dhenve të cilat shtegtojnë në rrethet e tjera.

Disa probleme të ngritura nga DRBUMK-të kanë të bëjnë me skemën e mbështetjes për instalimin e sistemit të ujitjes me pika në pemtoret intensive si numri i bimëve për Ha, parcela vetëm me 1 kulturë etj.

Niveli i ulët i mbështetjes për agropërpunimin etj.

Në skemën e mbjelljeve të reja në pemtari vreshtari dhe ullishte, ulja e kufirit minimal të sipërfaqes së mbjellë me vreshta deri në 0.3 Ha.

Mbjellje jo vetëm në 1 ngastër. Mosrespektimi i teknologjisë së kultivimit. Mbjellja e kultivarëve jashtë rajonizimit etj.

## **IV. Aspekte pozitive të zbatimit të skemës së mbështetjes 2008**

Gjatë zbatimit të skemave për mbështetjen e prodhimit bujqësor 2008 u dalluan dhe disa pika të forta, të cilat përbëjnë një bazë pozitive experience për zbatimin e skemave të mbështetjes 2009 dhe më tej.

- ❖ Informimi dhe publiciteti në shkallë të gjerë i masave për mbështetjen e bujqësisë 2008.
- ❖ Pritja dhe kontrolli i dokumentacionit të projekteve sipas fushave të mbështetjes, i ardhur nga DRBUMK-të e qarqeve u krye brenda afateve të përcaktuara në udhëzim, gjë që solli realizimin e objektivit për likuidimin financiar të projekteve fitues në kohë pa vonesë duke sjellë efektivitet të lartë të punës.
- ❖ Kontrolli me përzgjedhje në terren nga Projekti 2KR i zbatimit të projekteve sipas fushave të mbështetjes, i cili bëri që nga kontrolli i punës së grupeve të verifikimit të dalin në kohë të metat e grupeve të verifikimit dhe përmirësimi i tyre në kohë.
- ❖ Analiza në kohën e caktuar dhe zgjidhje nga Projekti 2KR të ankesave dhe reklamimeve të bëra nga fermerë të ndryshëm në lidhje me problemet e dala gjatë zbatimit të skemave të mbështetjes.
- ❖ Likuidimi financiar i fermerëve përfitues nëpërmjet llogarive bankare vetiake, gjë që rrit shpejtësinë e likuidimit financiar të tyre dhe ul mundësinë e abuzimeve.